



Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_732_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16, Nenit 18, Nenit 22 dhe Nenit 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr.03/-048);
- Dispozitat e Ligjit për Buxhetin e Kosovës për Vitin 2015 (Ligji Nr. 05/L-01);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Taksat; dhe
- Propozimin e ZRRE-së për lirim të të licencuarve nga pagesa e taksës vjetore të datës 07.04.2015.

Në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015, nxori këtë:

VENDIM

- I. LIROHEN** nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për periudhën nga data 01 mars 2015 deri 31 tetor 2015 të licencuarit:
 - KEK SH.A TC Kosova A - për prodhim të energjisë elektrike;
 - KEK SH.A TC Kosova B - për prodhim të energjisë elektrike dhe termike (bashkëprodhim);
 - KELKOS ENERGY SH.P.K - për prodhim të energjisë elektrike;
 - N.P "IBËR-LEPENC" - për prodhim të energjisë elektrike
 - KES|CO - për import të energjisë elektrike; dhe
 - Të gjithë të licencuarit tjerë që kanë të drejtë të importojnë energjinë elektrike.
- II. LIROHEN** nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për periudhën nga data 15 tetor 2015 deri 15 prill 2016 të licencuarit:
 - Ngrohtorja e Qytetit GJAKOVA Sh.A - për prodhim të energjisë termike,
 - Ndërmarrja publike "TERMOKOS" SH.A. - për prodhim të energjisë termike në ato raste kur prodhon nga ngrohtorja e vet.
- III. OBLIGOHEN** të licencuarit e energjisë termike që ta paguajnë borxhin nga periudhat paraprake, në të kundërtën lirimi nga pagesa e taksës vjetore sipas pikës II të këtij dispozitivi nuk vlen.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji mbledh taksa të inkasuara nga ndërmarrjet e licencuara dhe aktivitetet tjera, të cilat taksa janë të hyra të dedikuara për ZRRE-në. Taksat vjetore të licencimit dhe taksat tjera janë të përcaktuara sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Taksat.
2. Taksat vjetore të licencimit mblidhen në mënyrë që të mundësohet vetë qëndrueshmëria financiare e ZRRE-së për veprim me kosto efektive.
3. Për shkak të specifikave të sektorit të energjisë termike, të cilat operojnë vetëm gjatë sezonit dimëror (nga periudha tetor i vitit paraprak - prill të vitit vijues) dhe rrjedhimisht faturohen për taksën vjetore të licencuarit vetëm për këta muaj; kështu që të licencuarit për prodhimin e energjisë termike Ndërmarrja publike "TERMOKOS" SH.A. dhe Ngrohitorja e Qytetit GJAKOVA Sh.A lirohen nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për periudhën tetor 2015-prill 2016.
4. Zyra e Rregullatorit për Energji pas arritjes së vetë qëndrueshmërisë financiare dhe me qëllim të harmonizimit të "Të Hyrave me Buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015", liron të licencuarit nga pagesa e taksës vjetore të licencimit sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që:
 - 4.1 Të Hyrat e mbledhura për periudhën për të cilën nuk janë të liruar nga pagesa dhe në pajtim me Nenin 7 dhe 8 të Rregullës për Taksat, do të jenë të mjaftueshme për plotësimin e Buxhetit të planifikuar të ZRRE-së për vitin 2015.
 - 4.2 Lirimi nga pagesa e kësaj takse për këtë periudhë, për ndërmarrjet që prodhojnë energji elektrike dhe termike do të reflektohet në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për periudhën e ardhshme të shqyrtimit të tarifave (viti 2016), përmes bashkërendimit të të Hyrave të Lejuara.
- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:


- Të licencuarve (KEK SH.A TC Kosova A dhe TC Kosova B; N.P "IBËR-LEPENC", Kelkos Energy SH.P.K; KES|CO; Ndërmarrja publike "TERMOKOS" SH.A.; Ngrohitorja e Qytetit GJAKOVA Sh.A)

- Punonjësve financiar të ZRRE-së, dhe
- Akrivit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar